
PROBLEME E DISKUTIME

BARDHYL DEMIRAJ

SI TA LEXOJMË LAJBNICIN?

I. Problematika dhe diskutimi përkatës

Leximet e fundit kritike të trashëgimisë albanologjike kanë nxjerrë rishtas në pah dy anë të një problemi, që rëndon prej kohësh shkencën dhe shkollën tonë albanologjike. Duke rishtuar për diskutim shkrimet e filologozofit dhe të eruditit të madh gjerman Gotfrid Vilhelm Lajbnic (Gottfried Wilhelm Leibniz) mbi gjuhën shqipe, vëmë theksin mbi nevojën e gjithherershme për plotësimin e analeve të historisë së mendimit albanologjik: së pari, me të dhëna të sakta të karakterit filologjik e bibliografik për atë trashëgimi që disponojmë; e së dyti, me shkallën e njohjes, që përshkon debatin albanologjik në fazën e parë të dokumentimit të tij.

Lidhur me trashëgiminë e Lajbnicit, anën e parë të kësaj çështjeje e motivon deri diku shumësia e eseve dhe e veprimtarisë së tij epistolare, botimet e hershme, si edhe mungesa deri sot e ribotimit të veprës së tij në formë të plotë. Sidoqoftë, jo më pak i vështirëson vëzhgimet sintezë edhe mungesa e një antologjie të mendimit albanologjik, që do të mundësojë përditësimin e çdo të interesuari me trashëgiminë albanologjike, të mbledhur deri sot për këtë periudhë¹. Kjo mangësi ka lejuar edhe raste, kur shkrimet e Lajbnicit dhe përfundimet e arritura në to të vlerësohen – siç ankohej Konica një shekull më parë – "... prej shkrimtarësh që s'i kishin lexuar fare." (f. 41). Pa dashur t'u mëshojmë në studimin tonë rasteve të tilla, mendojmë se në studimet kritike mbi Lajbnicin kemi pasur shpesh pasigurinë, nëse kemi ose jo në tavolinën e punës të gjitha shkrimet e tij mbi shqipen. Si rast tipik i kësaj pasigurie mund të sillet ballafaqimi i numrit të përqasjeve etimologjike në shkrimet e Lajbnicit me ato të shkrimeve kritike dhe bibliografike mbi të.

¹ Ribotime të pjesshme të tyre i ndeshim të disa autorë: Engjëll Mashi (Angelo Masci), *Discorso sull'origine, costumi, e stato attuale della nazione albanese*, Napoli, 1807, f. 14, shën. 1; F. Konica, *L'opinione de Leibnitz sur la langue albanaise*, në: "Albania" nr.3 [1897], 41-43 (i plotë); N. Reiter, *Leibniz'ens Albanerbriefe*, në: "Zeitschrift für Balkanologie", 16 [1980], 82-88; J. Kastrati, *Historia e albanologjisë*, Tiranë, 2000, f. 171-172.

Dihet që debatin albanologjik të kësaj periudhe e trashëgojmë të cunguar. Por shkalla e njohjes së rrethanave, e sidomos e materialit albanologjik, me, në dhe mbi të cilin është zhvilluar ky debat, lejon gjithsesi interpretime bindëse si të synimeve ashtu edhe të rezultateve të arritura në të. Mosmbajtja e tyre parasysh gjatë shkrimeve kritike e lëkund lexuesin edhe për ato përsiatje a përfundime që ne, me kutin matës të dijes së sotme, i kundrojmë si të qëlluara. Duke iu referuar përsëri shkrimeve të Lajbnicit, vështirë se mund të përcillet pa mëdyshje teza e tij mbi origjinën ilire të shqipes, të cilën ai e formulon në një rresht të vetëm, e që shpesh vetëm konstatohet si “intuitë e jashtëzakonshme” e Lajbnicit në historinë e albanologjisë dhe të ilirologjisë².

Çështje të kësaj natyre ngërthejnë në vetvete edhe objektin e kësaj kumtese, ku synojmë të plotësojmë sadopak ato boshllëqe e, në këtë mënyrë, të përforcojmë mendimin mbizotërues mbi vendin e Lajbnicit në historinë e albanologjisë. Pas një sistemimi të etapave të interesimit dhe të pjesëmarrjes së tij në debatin intelektual të kohës, do të ndalemi më gjerë në ato çështje të karakterit gjuhësor-historik e filologjik, të cilat nuk i janë nënshtruar ende hulumtimit të mirëfilltë, si p.sh.: mëdyshja e Lajbnicit mbi origjinën sllave të shqipes, teza e tij mbi burimin e saj ilir, numri i saktë i përqasjeve të tij etimologjike e ndonjë tjetër.

II. Shqipja në qerthullin e interesave gjuhësorë-historikë të Lajbnicit Letrat e shqiptarëve

Përcaktimi në kohë i interesimit të Lajbnicit për gjuhën shqipe është i kushtëzuar me trashëgiminë e shkrimeve të tij, që njohim deri sot. Kemi të regjistruara gjithsej shtatë fragmente lettrash, ku shkruhet për shqipen me emërtimet e barasvlershme: *shqipja*, *gjuha shqipe*, *gjuha e shqiptarëve*, *gjuha epirote*, *gjuha e epirotëve*, dhe një rast kur parakuptohet ajo³. Duke shqipëruar emërtimin e balkanologut gjerman Norber Rajter (Norbert Reiter), këto fragmente mund t'i përbledhim këtu nën emrin *letrat e shqiptarëve* (gjerm. [Leibniz'ens] *Albanerbriefe*)⁴.

Ndër to ende i padatuar është një fragment, i marrë nga shkrimi me titull *Desiderata circa linguas populorum* [Desiderata mbi gjuhët e popujve],

² Shih Dh. Shuteriqi, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, Tiranë, 1976, f. 101; J. Kastrati, *vep. cit.*, f. 171, 172-173 (me një përbledhje të zgjeruar të literaturës albanologjike mbi Lajbnicin në f. 180-183).

³ Letra nr. 1: "...linguam singularem reperiri in montibus Albaniae vel Epiri."

⁴ N. Rajteri përdor në *art. cit.* këtë emërtim, duke u mbështetur në tri letra, të cilat ai i radhit me shifrat romake I, II, III. Në studimin tonë ato radhiten sipas rendit kronologjik me numrat 2, 3 dhe 4.

në epistolën drejtar Podestas, interpret i Cesarit dhe profesor i gjuhës turke⁵ Është fjala për një letër qarkore, që Lajbnici u drejtonte kohë pas kohe dijetarëve të ndryshëm, të cilëve u lutej të mblidhnin të dhëna me karakter gjuhësor-historik dhe leksikologjik për gjuhë pak të njohura ose fare të panjohura për të dhe për rrethet intelektuale ku bënte pjesë. Data e hartimit të kësaj qarkoreje nuk është saktësuar ende, ndërkoq që adresimi më i vjetër i saj, duhet të jetë bërë të paktën para datës 14 maj 1695, kur Lajbnici merr mbi këtë qarkore një përgjigje nga Vjena prej dijetarit Bodo von Oberg⁶.

Ndërsa këtë datë mund ta pranojmë qoftë edhe *ad hoc* si fillim i interesimit mbi gjuhën shqipe si nga ana e Lajbnicit ashtu edhe nga rrethet intelektuale, ku ai bënte pjesë, pjesëmarrja e tij në debatin shkencor fillon 10 vjet më vonë, në letërkëmbimin me orientalistin francez La Kroce (La Croze): gjithsej 5 fragmente lettrash të ndryshme⁷. Pavarësisht nga rrethanat ende të pasqruara, se si është nxitur ky debat, nga përbajtja e fragmentit të parë, drejtar La Kroces më 24 qershori 1705⁸, mësojmë, ndër të tjera: a) se korresponduesit nuk kanë shtënë ende në dorë material gjuhësor të shqipes; b) se Lajbnici shpreh dyshimin e tij për origjinën sllave të gjuhës së shqiptarëve, "sepse kjo gjuhë [mbi]zotëron përgjatë brigjeve të Adriatikut", pikërisht pranë Raguzës, dhe që e quajnë gabimisht *lingua illirica*. Në letër ai përsiat gjithashtu mundësinë e pranisë së ndonjë gjurmë të gjuhës së ilirëve të vjetër në malësitë e Epirit, duke saktësuar kështu emrin e asaj gjuhe, për të cilën kërkon të dhëna në qarkoren e 10 vjetëve më parë.

Pika kulmore të debatit shkencor shënojnë dy letrat vijuese, drejtar La Kroces 4 vjet më vonë, me një diferencë kohore prej 16 ditësh. Korresponduesit janë përditësuar tashmë me material albanologjik. Në fragmentin e parë (letër e datës 10 dhjetor 1709) Lajbnici shkruan, ndër të tjera, për një libër (përkthimi *Doctrina Christiana* i Pjetër Budit, ribotim i vitit 1664) dhe një fjalor (*Dictionarum latino-epiroticum* i Frang Bardhit), nga ku mëson se cila ishte

⁵ G.W. Leibniz, *Desiderata circa linguas populorum, ad Dn. Podesta*, në: *Opera omnia VI*, Gjenevë, 1768, f. 228-230. Në këtë letër kërkesa për gjuhën shqipe është renditur në rubrikën nr. 10. Shih edhe shën. 7.

⁶ Datë, në të cilën Bodo von Oberg i kthen përgjigje letrës së mëparshme të Lajbnicit (? mes i muajit janar të vitit 1695), së cilës i ishte bashkëngjitur qarkorja. Në këtë qarkore kërkesa për mbledhjen e të dhënave mbi gjuhën shqipe përfshihet në rubrikën nr. 12.; shih më hollësishët në: G.W. Leibniz, *Sammelwerke*, vëll. 11 (seria I), Berlin, 1982, f. 170-176.

⁷ G.W. Leibniz, *Opera omnia V*, Gjenevë, 1768 (ribotim: Hildesheim - Zürich - New York, 1989), f. 478, 494, 497, 499, 507. Në studimin tonë këto letra i kemi radhitur sipas rendit kronologjik të trashëgimisë së Lajbnicit me numrat 2, 3, 4, 5, 7.

⁸ N. Rajteri (*art. cit.*, f. 82) shënon gabimisht datën 24 janar 1705, e pas tij edhe ndonjë gjuhëtar i mëvonshëm që është mbështetur në punimin e tij.

gjuha e ilirëve të vjetër dhe që (shqipja) ka shumë latinizma. Gjatë leximit filologjik të *Lutjes së të Dielës* (që është marrë me siguri nga përkthimi i Budit), ai vëren gjithashu afëri gjuhësore më gjuhët skithe dhe me gjermanishten, duke i ilustruar ato me tri togje fjalësh dhe me një emër⁹. Në fragmentin tjetër (letër e datës 26.12.1709) ai i përkushtohet tërësisht interpretimit filologjik dhe etimologjik të dhjetë emrave, të nxjerrë nga fjalori i Bardhit¹⁰. Rëndësi të veçantë në leximin kritik të këtyre dy letrave ka edhe një letër faksimile e shkruar gjatë kësaj periudhe, të cilën e zbuloi balkanologu gjerman N. Rajter. Ajo përmban *Lutjen e së Dielës*, të pajisur me disa shënimë për burimin nga është marrë (DC e Budit), si edhe për disa veçori të alfabetit të shqipes¹¹.

Dy letrat e fundit, drejtuar La Kroces (28.12.1711; 24.3.1714) fitojnë rëndësi kryesisht të karakterit bibliografik dhe historiografik, pasi orientojnë në kohë kërkimet për zbulim të mundshëm të ndonjë shkrimi ende të panjohur të Lajbnicit për gjuhën shqipe. Në to mësojmë, ndër të tjera: a) që Lajbnici interesohet herë pas here për gjuhën shqipe; b) se ai u mbetet besnik përfundimeve të tij mbi origjinën ilire të shqipes; dhe c) se parapëlqen ta emërtojë shqipen si *gjuhë epirotike*, përkatësisht *gjuhë të epirotëve*.

Interes paraqet fragmenti i epistolës drejtuar Çambërlenis (Chamberlain) më 13 janar 1714¹². Këtu Lajbnici, ndër të tjera: a) kundërshton mendimin e disa dijetarëve të kohës, sipas të cilëve gjuha e vjetër ilire ka qenë e burimit sllav; dhe b) ngul këmbë sérishmi në tezën e tij, që relike të saj ruhen në gjuhën shqipe.

Nga kjo paraqitje e thukët e trashëgimisë albanologjike të Lajbnicit arrijmë paraprakisht në përfundimin, se: a) interesi i Lajbnicit për shqipen dotohet përgjatë një periudhe kohore prej të paktën 20 vjetësh (deri një vit para vdekjes së tij); b) gjatë kësaj periudhe ai jo vetëm nxit debatin albanologjik në rrëthet intelektuale, ku bën pjesë, por edhe merr pjesë në të; dhe së fundi c) ai hyn në debat me cilësinë e gjuhëtarit me interesa historikë, filologjikë dhe etimologjikë. Duke e përqendruar analizën kritike të letrave të shqiptarëve

⁹ *Ati-ynë, e-na-ndëje-ne, ndë-të-keq, dhe* (letra nr. 3).

¹⁰ *burrë, çizme, det, gaforre, grua, hundë, ka, krah, i mirë, mish* (letra nr. 4).

¹¹ N. Rajteri riboton këtë faksimile bashkë me tri letrat originale të Lajbnicit (*art. cit.*, f. 94-97). Sipas tij shkrimi i faksimiles nuk përkon me shkrimin e Lajbnicit (shih E. Hamp, *On Leibniz's Third Albanian Letter*, në: "Zeitschrift für Balkanologie" 17 [1981], 35). Ky fakt mund të vështrohet edhe si tregues i pjesëmarrjes më të gjerë në debatin albanologjik të kësaj periudhe.

¹² G.W. Leibniz, *Epistola, insigni viro Johanni Chamberlaynio*, në: *Opera omnia*, vëll. VI, Gjenevë, 1768 (ribotim: Hildesheim - Zürich - New York, 1989), f. 193. Sipas radhës kronologjike kjo letër renditet e gjashta.

pikërisht në këtë cilësi të tij dhe brenda kuadrit të këtyre interesave¹³, përcjellim më me siguri edhe ato përsiatje që yshtin lehtë në vlerësimë kundërthënëse.

III. Lajbnici për prejardhjen e gjuhës shqipe, teza ilire

1. Mëdyshja: "... kam frikë se mos është e llojit sllav, sepse..."

Në leximet e derisotme kritike, mëdyshja e shprehur në letrën nr. 2 (për nga radha kronologjike) ose është lënë në heshtje ose është vështruar si fakt, që Lajbnici fillimi isht ka hedhur tezën a ka përkrahur një të tillë, që mbështete burimin sllav të shqipes¹⁴, duke u distancuar kështu nga teoria ilire e shqipes, që duhej të ishte një *opinio communis* në rrethet intelektuale, ku bënte pjesë¹⁵. Mosnjohja ende e rr Ethanave në të cilat u shkrua letra (ose më mirë të themi letër-përgjigjja) lë sigurisht shteg për disa interpretime. Nga vetë përbajtja e saj mësojmë gjithsesi se është fjala për mëdyshje të letërshkruesit, e cila në mënyrën se si është formuluar vështirë se i kapërcen caqet e një hipoteze.

Në letër Lajbnici pohon se nuk e njeh gjuhën e shqiptarëve, megjithatë dyshon se mos ajo është gjuhë sllave dhe si të tillë e quajnë gabimisht *lingua illirica*. Gjithashtu beson se gjuha e ilirëve të vjetër ishte diçka krejt tjetër (d.m.th. josllave), duke ngulur këmbë rishtas (në kërkësen e të paktën para 10 vjetëve), se në rast se do të ketë ende gjurmë të saj, ato duhen kërkuar në malësitet e Epirit). Mëdyshjen ai e argumenton me dy të dhëna paraprake, që ka marrë ndërkohë për këtë gjuhë, ndër të cilat: a) njëra është (edhe për lexuesin kritik) e paplotë: shtrirja e gjuhës së shqiptarëve (vetëm) përgjatë brigjeve të Adriatikut, bash në kufi me Raguzën; ndërsa b) tjetra është për Lajbnicin vetë e pasaktë: emërtimi *lingua illirica*, i cili, siç do ta ndeshim disa herë më poshtë, ishte i përhapur në rrethet intelektuale të kohës për të dalluar gjuhët sllave të Ballkanit. Ne vëmë theksin pikërisht tek ky emërtim pështjellues i asaj kohe, që e shqetëson vazhdimisht Lajbnicin në shkrimet e tij. Në një numër syresh ai e kritikon mendimin sundues, sipas të cilit popullsitet sllave të Ballkanit të jenë me origjinë ilire, e më tej që gjuha e tyre të quhej *lingua illirica*. Këtë ai e

¹³ Në studimin e tij kritik N. Rajteri përqendrohet kryesisht në interesat filozofike-gjuhësore të Lajbnicit dhe në punën e tij me etimologjinë (*art. cit.*, f. 84-93). Shih edhe N. Çabej, *Autoktonia e shqiptarëve në studimet gjermane*, Tiranë, 1990, 41vv.; A. Hetzer, *Kontributi i Josephon Ksilanderit për albanologjinë*, në: *Kontributë të albanologjeve të huaj për studimin e gjuhës shqipe*, Shkodër, 1996, f. 77.

¹⁴ Shih Dh. Shuteriqin dhe J. Kastratin në vendet e cituara.

¹⁵ N. Reiter, *art. cit.*, f. 83vv.

kundërshton me argumentin historik, që këto popullsi janë ngulur vonë në Iliri¹⁶.

Distancimin e Lajbnicit nga kjo tezë e përjetojmë te letrat e shqiptarëve në dy mënyra: a) duke ritheksuar argumentin historik: "... sllavët janë ngulur vonë në Iliri, jo para kohës së Justinianit" (letra nr. 6); dhe b) duke i mbetur gjithnjë konsekuent emërtimeve të popullit të lashtë ballkanik, të ashtuquajturve *ilirë të vjetër* (: lat. *Illiri veteres*, fr. *anciens Illiriens*) dhe të gjuhës së tyre të veçantë, të cilën e perifrazon gjithnjë si *gjuha e ilirëve të vjetër* (fr. *la langue des anciens illiriens*). Në këtë kuadër, edhe mëdyshja e tij për origjinën e mundshme sllave të gjuhës së shqiptarëve është e motivuar, e po aq e kushtëzuar nga mosnjohja e saj.

2. Teza: "... nga ku ne mësojmë se cila ishte gjuha e ilirëve të vjetër".

Kështu prekim çështjen më të vështirë në letrat e Lajbnicit: tezën e tij për origjinën ilire të shqipes (letra nr. 3). Ndërsa mëdyshjen për origjinën sllave të shqipes Lajbnici e motivon, për bindjen e tij, se shqipja është gjuha e ilirëve të vjetër ai nuk hedh në letër asnje argument. Formulimi i saj në më pak se një rresht jep sigurisht shkas për më shumë se një interpretim. Një të tillë, ndoshta të vetmin, e ndeshim në studimin e Rajterit, sipas të cilët Lajbnici i bashkohet një *opinio communis* të rretheve intelektuale të asaj kohe. Këtij bashkimi i ka dhënë shkas, sipas tij, leximi i faksimiles së *Lutjes të së Dielës* (*Ati ynë*), në krye të së cilës mbishkruehet: *Lingua Epirotica sive Albanesia* (Gjuha Epirote ose/përkatësisht Shqipe). Emërtimet e barasvlershme *gjuhë epirote : gjuhë shqipe* kanë nxitur, sipas tij, Lajbnicin, që të identifikojë *shqipen* me *ilirishten*, të cilën e kërkonte një letër më parë pikërisht në *Epir*. Kemi të bëjmë pra, shkruan Rajteri, me një "sîc duhet të themi ndoshta sot – pseudoidentifikim të shqipes me ilirishten ..." (f. 88).

A kemi të bëjmë këtu thjesht me një "një pseudoidentifikim"? Ky përfundim në pamje të parë nuk është i pamotivuar. Mjafton të lexojmë formulimin e thukët të tezës, duke e bashkëlidhur atë me letrën pararendëse si dhe me titujt e materialit shqip, që ka shfrytëzuar Lajbnici gjatë hartimit të saj. Rajteri shtron edhe dy argumete, që në vetvete janë gjithsesi kundërthënëse: a) shkrime a mbishkrime ilire Lajbnici nuk dispononte; ndërkokë që, sipas tij, b) teza ilire e prejardhjes së gjuhës shqipe duhej të ishte sunduese në kohën e tij. Që argumenti i dytë nuk qëndron, këtë e shqyrtuan më sipër. Por që argumenti

¹⁶ Shih, ndër të tjera, letrën drejtuar Çambërlenit (letra nr. 6): "... Slavonicam linguam hodie Illyricam vulgò vocant, quod Slavi in Illyriō consedêre" (*Opera Omnia VI*, f. 197);

i dytë, edhe pse s'mund ta quajmë bindës, qëndron, këtë e përjetojmë sot e gjithë ditën edhe në shkrimet ku mëtohet prejardhja ilire ose joilire e shqipes. Sidoqoftë atë vështirë se mund ta përdorim si argument ose si kundërargument, kur lexojmë Lajbnicin. Për lexuesin kritik është me interes të mësojë se si dhe pse arriti Lajbnici në këtë përfundim.

Mëjanimi i dy argumenteve të mësipërme rihap kështu shtegun e leximit kritik të kësaj teze. E për këtë i detyrohem sigurisht Rajterit si i pari kritik që bashkëlidh tezën e Lajbnicit me materialin gjuhësor, tek i cili ai mbështetet. Këtë bashkëlidhje e ndeshim gjithsesi të shprehur qartë në vetë formulimin e Lajbnicit: "... një libër dhe një fjalor të gjuhës shqipe, nga ku ne mësojmë, se cila ishte gjuha e ilirëve të vjetër"¹⁷. Është pikërisht fjala "mësojmë" që të nxit të zgresësh në tekst, duke e shqyrtuar atë jo thjesht si burim materiali shqip, por edhe si përditësim të Lajbnicit me letërsinë albanologjike të asaj periudhe. Njëri ndër librat që shfrytëzon Lajbnici është fjalori i Bardhit, një vepër e mirëfilltë albanologjike¹⁸.

Para se të kalojmë te ky fjalor, le të hapim një parantezë, duke u ndalur shkurt në letrën faksimile të *Lutjes së të Dielës*, tek e cila mbështetet edhe Rajteri, kur interpreton Lajbnicin. Siç u cek edhe pak më sipër, në të janë dhënë dy shënime plotësuese. I pari ka të bëjë me burimin nga është marrë lutja, i cili është përkthimi i Budit "Doctrina Christiana" (ribotim i vitit 1664). Në të dytin bëhen sqarime për alfabetin latin të shqipes, kryesisht për tri grafemat jolatine të tingujve [z, y, þ], që përdor Budi. Duke ballafaquar këtë shënim me nënkreun hyrës të fjalorit të Bardhit, të titulluar "Vërejtje mbi gjuhën dhe alfabetin e epirotasve përkatesisht të shqipëtarëve" (*Annotationes de lingua, & litteris Epirotarum, seu Albanesiorum*, f. VI/2), vërejmë menjëherë se ai është marrë, madje pjesërisht fjalë për fjalë, pikërisht nga kjo pjesë e veprës¹⁹. Ky nënkyre hyrës i veprës, ka qenë pa dyshim ndër të parët që ka lexuar Lajbnici. Këtu ai ka mësuar fillimi shqip, për t'u përditësuar më

¹⁷ ".... Vous m'avez fait beaucoup de plaisir, en me mandant d'avoir reçu un livre & un Dictionnaire de la Langue Albanoise; par là nous apprenons quelle étoit la langue des anciens Illyriens. ..." (*Opera omnia* V, f. 494).

¹⁸ Rëndësinë që ka pasur kjo vepër për Lajbnicin gjatë qëmtimit të etimologjive shqipe e ka saktësuar në detaje E. Hempi gjatë leximit kritik të letrës nr. 4; shih E. Hamp, *art. cit.*, f. 34-36. Konica është gjithsesi i pari lexues kritik, që ka saktësuar burimin e fjalorit shqip që ka shfrytëzuar Lajbnici. Sipas tij. (*art. cit.*, f. 42) "Il s'agit sans doute du *Dictionarum latino-epiroticum* de BLANCHI (in -8°, Rome, 1635)".

¹⁹ Krahaso në faksimile (shënim poshtë lutjes): "... Epirotae tres tantum litteras habent sibi peculiares. ε, γ, ξ. Prima ε pronuntiatur ut z, secunda γ, ut u Gallorum, tertia ξ ut Th.", me një pjesë të nënkreut hyrës te fjalori i Bardhit: ".....Figurae ε, γ & [= et] ξ. Prima pronuncianda est, ut Z. Secunda omnino, ut V more Gallorum. Tertia, ut Th." (Frang Bardhi, *Dictionarum ...*, f. VI/2).

pas edhe me lëndën e fjalorit si edhe me pjesë shqip nga përkthimi i Budit. Pa dashur të rrudhim sadopak interesimin e Lajbnicit për këto shënime ortografike sqaruese, duam të vëmë theksin, në mënyrën se si ka përcjellë ai fjalinë, që u paraprin atyre. Aty lexojmë (në latinisht), që : "Idioma e veçantë e popullit epirotas ose [= përkatësisht] gjuha shqipe është në mënyrën e të shprehurit krejt e ndryshme nga greqishtja dhe [nga] ilirishtja ose [= përkatësisht] sllavishtja, edhe pse shtrihet [= flitet] midis të dyjave; kufijtë [gjeografikë] të popullit ashtu si [edhe] mjedisi paraqiten sikur të jenë përfstuar [prej saj]"²⁰. Është pikërisht ky fragment-fjali, shkruar 75 vjet më parë, nga ku Lajbnici mëson atë që kërkon prej më se 15 vjetësh: një "*një linguam singularem* që gjendet [= flitet] në malësitë e Shqipërisë dhe të Epirit", e cila edhe në letërsinë albanologjike nuk u quaka *lingua illirica*.

A kemi të bëjmë me një pseudoidentifikim, kur Lajbnici tashmë bindet, se cila ishte gjuha e ilirëve të vjetër? Këtë pyetje, siç përmendëm më sipër, nuk na takon ta bëjmë, kur interpretojmë Lajbnicin. Neve na interesojnë më shumë motivet që e shtynë atë në këtë përfundim. Duke lexuar hyrjen e Bardhit e duke studiuar nëpërmjet saj edhe materialin shqip, ai fiton të paktën dy motive, që e lejojnë të përsiasë bashkëlidhjen: *gjuhë shqipe/epirote* : *gjuhë e ilirëve të vjetër*. Këto janë a) hapësira gjeografike, dhe b) veçoritë dalluese të shqipes nga gjuhët e tjera pérreth, të cilat ai i njeh dhe di t'i dallojë mirë. Këtë bashkëlidhje Lajbnici e emëront ndryshe, për ta dalluar nga simotra e saj *gjuhë sllave* (e Ballkanit) : *lingua illirica*, që ishte aq e përhapur në kohën e tij. Në fazën e fundit të aktivitetit të tij intelektual, ai ndoshta ka evoluar edhe konceptimin e saj, duke e parë atë në boshtin kohor. Për të qartësuar këtë konceptim duhet t'i referohemi fragmentit të njërsës nga letrat e tij të fundit, ku ai shkruan "... që reliket e saj [= të gjuhës së ilirëve të vjetër] ruhen në gjuhën e sotme, të veçantë të epirotëve ..." (letra nr. 6)²¹.

IV. Interesat filologjikë dhe etimologjikë të Lajbnicit

Duke vijuar leximin e letrës nr. 3. si edhe të letrës nr. 4 përcjellim një anë tjetër të interesit historik-gjuhësor të Lajbnicit: punën e tij me gjuhën shqipe. Lajbnici e studion shqipen me një synim të caktuar: të përzgjedhë ato relike, atë pronë të shqipes, që ajo ka trashëguar prej gjuhës së ilirëve të vjetër, që ne quajmë sot leksiku indoevropian. Lidhur me kërkeshën e tij: "Do të ishte mirë të dallohej në shqipen çka është e vetja prej asaj që është huazuar" (letra

²⁰ "Proprium Epiroticae gentis idioma, seu Albanesia lingua à Graeca, & Illyrica, seu licet inter vtriusq; gentis confinia veluti media constituta conspicitur." (Frang Bardhi, *vendi i cit.*).

²¹ "... Et credibile est, ejus reliquias in peculiari quâdam linguâ Epirotarum hodiernâ superesse, cuius specimina edita vidi...." (letra nr. 6.).

nr. 3), e ngritur me të drejtë nga Jokli²² si detyrë-parim në albanologji, është shkruar shumë; po ashtu edhe për metodat, që ai zbaton. Gjithsesi mbetet për t'u rregulluar ndonjë e dhënë, e regjistruar gabim.

Në shkrimet kryesisht bibliografike për Lajbnicin ose në sosh që i referohen atij ndeshim shpesh vërejtjen, se ai, duke mos e njohur shqipen, ka bërë shumë gabime ortografike gjatë riprodhimit të fjalëve a të grupeve të fjalëve shqip. Këto vërejtje zënë fill me studimin e Engjëll Mashit më 1807 dhe përsëriten shumëkund deri në ditët tona²³. Që në letrën nr. 4 një pjesë e tyre buron prej fjalorit të Bardhit e ndonjë syresh do kërkuar gjatë shtypit të këtyre shkriimeve postume, këtë e ka analizuar me akribi filologjike Hempi²⁴. Si gabime gjatë përgatitjes për shtyp duan parë edhe shumica e shembujve të marrë nga Budì, që janë pasqyruar në letrën nr. 3. Nga një përqasje e faksimiles së Lutjes të së Dielës, ku pas gjase është mbështetur Lajbnici, me gjegjësen e saj në librin e Budit, ndeshim vetëm një shambahie nga originali²⁵.

Ndërsa zanafillën e vërejtjeve ortografike e diktojmë në veprën e Mashit, në përkthimin e saj frëngjisht të botuar me vërejtje kritike nga Malte Bruni më 1809 diktojmë një gabim, pasojat e të cilit i ndeshim edhe sot e kësaj dite në albanologji. Është fjalë për të ashtuquajturat 102 fjalë shqipe që Lajbnici shfrytëzon në përqasjet e tij etimologjike, e si të tilla ato mendohet që janë rimarrë në veprën e Mashit dhe janë përmirësuar më tej nga Malte-Bruni²⁶. Mund të përbledhim këtu shkurt se si mbledhja e 102 fjalëve ashtu edhe përqasjet e tyre të para me disa gjuhë i takojnë Mashit. Ai ka marrë nga një shkrim i Lajbnicit 62 fjalë të gjeorgjishtes²⁷ dhe i ka krahasuar ato më pas me gjegjëset shqipe, për të treguar se sa të ndryshme janë këto dy gjuhë nga njëratjetra. Referimet e shpeshta dhe vetë metoda e punës, me të cilën Mashi dhe më pas Malte-Bruni përpunojnë materialin shqip, na nxisin gjithsesi të pranojmë si të mirëqenë rolin e Lajbnicit si misionar i debatit albanologjik në rrethe të reja intelektuale të asaj periudhe, që kërkon përkushtim edhe në këtë shekull të ri.

²² "... Et credibile est, ejus reliquias in peculiari quâdam linguâ Epirotarum hodiernâ superesse, cuius specimina edita vidi...." (letra nr. 6.).

²³ E. Mashi, *vendi i cit.*

²⁴ E. Hamp, *vendi i cit.*

²⁵ Krh. Pjetër Budì: *ena ndeye nee* (DC 1664, f. 36); faksimile: *e nandeyc nee*; Leibniz (letra nr.3): *enandeyenée*.

²⁶ Shih E. Mashi, *vep. cit.*, f. 5vv., 25v.; C. Malte-Brun, *Annales des Voyages III*, Paris, 1808, f. 148, 167vv.

²⁷ G. W. Leibniz, *Epistola ad Andream Acoluthum* (10. Octob. 1695), në: *Collectanea etymologica* 1/2, pars II, Hanoverae, 1717 (ribotim: Hildesheim - New York, 1970), f. 172vv.

Shqipja në shkrimet filologjike të Lajbnicit

Letrat “e shqiptarëve”:

1. Letra e parë

drejtuar : a) Bodo von Oberg (: përgjigje më 14 maj 1695)

[I njëjtë text: b) Dn. Podesta (: Data ?), në: *Opera Omnia*, vëll. VI, f. 229]

Desiderata circa linguas populorum

Nr. 10 [Po] hulumtohet, se mos zbulohet në Shqipëri dhe në Bullgari një gjuhë e veçantë, krejt e ndryshme prej sllavishtes, hungarishtes, greqishtes dhe turqishtes, sepse thuhet që një e tillë gjuhë *unike* [= *linguam singularem*] gjendet në malësitë e Shqipërisë dhe të Epirit.

2. Letra e dytë, e tretë, e katërt, e pestë dhe e shtatë

drejtuar: Maturin Veyssiere La Croze

Opera Omnia, Bd. V: *Opera philologica*, Georg Olms Verlag, Hildesheim – Zurich – New York 1989 (Ribotim; Botimi i parë: Gjenevë, 1768)

(*Hannover, më 25 janar 1705*)

.... Sa për gjuhën e shqiptarëve, kam frikë se ajo është e një lloji sllav, sepse kjo gjuhë [mbi]zotëron përgjatë detit Adriatik. E quajnë gabimisht *gjuhë ilire*. Por unë besoj se gjuha e ilirëve të vjetër ishte diçka krejt tjetër; nëse do të ishte [prej saj] ndonjë mbeturinë në malësitë e Epirit, kjo do të ishte shumë interesante dhe e denjë për hulumtimin tonë. Unë kam menduar më shumë se një herë për të, por nuk më ra aspak ndërmend, kur qeshë në Romë, ku njoba, nëse s'gaboj, z. *Pastritio*, profesor i Kolegit të *Propagandës* [= *Propaganda Fide*], që vetë ishte ardhur nga Dalmacia. Nuk e di, nëse ai rron ende. Mund të dihet në Raguzë, ç'bëhet me të, dhe po ashtu në Venecie, meqë trojet e republikës janë [= shtrihen] fare pranë Shqipërisë.(f. 478).

(*Hannover, më 10 dhjetor 1709*)

Si kaloi këtej z. Hubener, i kthyer prej Holandës, unë e rëndova duke iu lutur për një dorëshkrim të Bibliotekës Mbretërore, të cilin po juad dërgoj duke ju falënderuar, dhe [me këtë rast] kam nderin t'ju shkruaj në të njëjtën kohë. Ju më dhatë kënaqësi të veçantë, duke ndërmjetuar që të merrja një libër dhe një fjalor të gjuhës shqipe, nga ku mësojmë, [se] cila ishte gjuha e ilirëve të vjetër. Ndërkaq unë vërej shumë latinizma. [Lutja] *Attiynë* “[fr.] notre père” përshtatet me gjuhët skithe; duket gjithashtu, që të ketë ndoca gjurmë fjalësh që përpunten

me gjermanishten, si [p.sh.] *dheet* “[fr.] terre”, *e-na-ndëje-nee* “[fr.] pardonner”, *ndë-të-keq* “[fr.] en tentation”....(f. 494)

(Hannover, më 26 dhjetor 1709)

Do të ishte mirë të dallohej në shqipen çka është e vetja prej asaj që është huazuar; askush s'mund ta bëjë këtë më mirë se ju, zotëri! Ndërkaq unë do shprehja mendimin tim për disa fjalë të kësaj gjuhe. *Hundë* “[lat.] naso”: mos duhet të themi se është keltizëm i vjetër? dhe që [gjerm.] *Hund* “qen” ta ketë pasur emrin e tij prej hundës, meqë ai dallohet me anë të përdorimit të këtij organi, sikurse [fr.] *truie* “*troia* [dose]” vjen në një mënyrë tjetër prej *trogue* ose *truyn* “hundë” te galët e vjetër, por edhe te galët e sotëm. *Hunting* tek englezët është “*gjahu*”; por *hint* ende do të thotë tek ta “*gjurmë*, *tregues*”, si[kurse] gjermanët e sotëm i thonë *Spuhr* “[*gjurmë*]”. Kështu që ka mundësi, që të gjitha këto të vijnë nga një rrënje që shënonë [kuptimin] “*njohje*”, prej së cilës mund të jenë përfshuar edhe [fr.] *connoître* dhe [gr.] *gnóoskein* “[me *njohë*]”. Unë nxjerr një rrjedhojë të ngjashme edhe për *krah* “[lat.] *brachium*” te shqiptarët, sepse [gjerm.] *Krebs* ose [fr.] *crabe* “[*gaforre*]” është një kafshë me *krahë* [= *këmbë*]; edhe [gjerm.] *Krallen* ([fr.] *griffes*) “[*kthetra*]”, [gjerm.] *kratzen* “me *gërvishë*”, *kriechen* “me u heqë zvarrë”, *Kröte* “*breshkë*” duket se ndërvaren me to. Brenda rrënjos [së një fjale] shkronja [= *tingulli*] *K* shënon shpesh [*nacionin*] e përkuljes, dhe shkronja *R* shënon lëvizjen në të; kështu që për *krahët* është [më se] e përshtatshme që të shprehen me [togun] *Kr*. Më duket se te sllavët *massa* do të thotë “*mish*”, kështu që kjo do të lidhej me [emrin] *mish* te shqiptarët dhe *mis* tek armenët, që do të thotë “*mish*” si te të parët ashtu edhe te të dytët. *Burri* “[lat.] *maritus*” mund të ketë lidhje me [gjerm.] *Braut* “[*nuse*], *Bräutigam* “[*dhëndër*]”, *Freia* [që është] *Venusi* i popujve teutonë. Lidhur me *gaforreja* “[lat.] *cancer*” te shqiptarët, unë supozoj, se ajo mund të ketë lidhje me [gjerm.] *Gafel* [= *Gabel*], që do të thotë [lat.] *furca*, [fr.] *fourchette*. Çizmet, të tillë që mbajnë zakonisht hungarezët, quhen në Vjenë *Citme*, sipas shqiptimit italian, d.m.th. *çisme*; kështu që do duhej shqyrtuar se mos *ocrea* nuk është “*çizmja*” te hungarezët a te ndonjë popull tjetër fqinjë, sikurse [është] tek shqiptarët. Numërorët shqip nuk kanë asgjë [të ngjashme], që të duket se vijnë nga ato të gjuhëve fqinjë. Por, nëse te shqiptarët [fr.] *boeuf* është *kau*, *mer* quhet *deet*, dhe *mulier* : *grue*, *bon[ne]* : *e mirë*, arsyen për këtë mund ta gjeni më mirë ju, zotëri, që njihni aq shumë gjuhë. Ndoshta është *deet* një shndërrim i [një paraforme] *delt* : gr. *thálassá* etj. (f. 495)

(Hannover, më 28 dhjetor 1711)

Me këtë rast, ju lutem shumë zotëri, të më dërgoni Lutjen e së Dielës në gjuhën epirote [= shqipe] me një version ndërlindore; dhe do t'ju detyrohesha po të

plotësohej *credo*, në qoftë se e lejojnë mundësitet tuaja; gjithashtu të më jepni titujt e dy librave të kësaj gjuhe, me përmusat dhe kohën e vendin e vëniec në shtyp. Sepse kjo gjuhë, duke qenë pak e njohur, meriton që të mendohet diçka për të. Unë do të mundohem t'i siguroj këta libra nga Roma. Kanë nxjerrë në dritë monumente të vjetra nën themelit e Nôtre Dame-it të Parisit (f. 499).

(*Hannover, më 24 mars 1715*)

Një ditë në Berlin ju më keni treguar një libër të gjuhës së veçantë të epirotëve, i shtypur në Romë te Propaganda [Fide]. Më duket se kishte Lutjen e së Dielës në këtë gjuhë dhe që unë e nxora. Por unë s'e gjej dot me lehtësi në letrat e mijë. A do të kishit mirësinë, zotëri, të ma kumtonit edhe një herë? (f. 507)

Letra e gjashtë

Drejtuar: Johann Chamberlain (Vjenë/Austri, më 13 janar 1714)

Alfabetet e sotëm evropianë janë përfshuar prej [atij të] latinishtes, me përjashtim të dy [alfabeteve] sllavë: njëri kirilishtë [dhe] tjetri (pak i gjetur, i ashtuquajtur) glagolishtë. Këtë [të fundit] më vonë disa autorë ia kanë dedikuar shën Hieronimit me origininë ilire, me bindjen e rreme, sikur gjuha e vjetër ilire të ishte e llojit [= burimit] sllav. Por sllavët kanë ardhur vonë në Iliri, dhe jo para kohës së Justinianit. Ilirët e vjetër ishin të burimit kelt. Ata përdornin një gjuhë shumë të afërt [= farefisnore] me gjermanishten dhe galishten. Dhe është e besueshme, që reliket e saj janë ruajtur në një gjuhë të sotme, të veçantë të epirotëve, prej së cilës unë kam parë [= lexuar] *specimina* [= copa leximi] të botuara. Sot e quajnë gjuhën sllave në përgjithësi ilire, sepse sllavët janë vendosur në Iliri.

Résumé

COMMENT DOIT-ON LIRE LEIBNITZ ?

Dans cet article regardant l'intérêt de Leibnitz pour les albanais et leur langue l'auteur a traité les questions suivantes: I. La problématique et la discussion respective, II. L'albanais dans le cercle des intérêts linguistiques-historiques de Leibnitz. "Les lettres des albanais", III. Leibnitz pour l'origine de la langue albanaise. La théorie illyrienne, IV. Leibnitz comme philologue et étymologue.

En se basant sur la correspondance de Leibnitz avec les savants de son temps, l'auteur a esquissé l'évolution de l'opinion de Leibnitz sur l'origine des albanais et de leur langue, une évolution conditionnée par les informations, qu'il s'en procurait de temps en temps. En tenant compte des données concrètes, l'auteur a mis en évidence que Leibnitz à la fin est arrivé à la conclusion que l'albanais est une langue toute

diverse des langues slaves et qu'il tire son origine de la langue des anciens illyriens. A la fin de son article l'auteur a voulu corriger l'opinion erronée, selon laquelle Leibnitz se soit occupé aussi de la comparaison de 102 mots albanais avec des mots correspondants de certaines autres langues. Il a affirmé que cette comparaison en réalité est due à Angelo Masci, dont l'œuvre a été reproduite en français par Malte-Brun.